

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Frosina Sylejmani kryetare, Fejzullah Rexhepi dhe Isa Shala anëtarë, në çështjen juridike të paditësit G.B. nga fshati ... Komuna e Lipjanit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat N.G. nga Lipjani, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) në Prishtinë, në çështjen për kompensim të dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan C.nr.141/13 të datës 09.01.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 27.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat e paditësit G.B. nga fshati ... Komuna e Lipjanit dhe të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve – BKS, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan C.nr.141/13 i datës 09.01.2014 VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës së shkallës së parë, C.nr.141/13 të datës 09.01.2014, me pikën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësit G.B. nga fshati ... Komuna e Lipjanit dhe është detyruar e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) në Prishtinë, që paditësit në emër të dëmit jo material të shkaktuar si pasojë e lëndimeve të marra në aksidentin e shkaktuar më datë 13.04.2009 t’ia paguaj shumat dhe atë në emër të dëmit jo material: për dhimbje fizike shumë prej 1.000euro, për frikën e përjetuar shumë prej 800euro, për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit trupor shumë prej 500 euro, të gjitha këto shuma me kamatë vjetore që paguajnë bankat për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar duke filluar nga data 08.11.2013 deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 811 euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh që nga dita e formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Me pikën II të dispozitivit është refuzuar kërkesëpadia e paditësit mbi lartësinë e aprovuar për dëmin jo material: në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 1.000 euro deri në 1.500 euro, për frikën e përjetuar shumë prej 800euro deri në 1.000 euro, për dëmin material: në emër të ndihmës dhe përkujdesjes së personit të tretë në shumë prej 30 euro dhe ushqim të përforcuar në shumë prej 60 euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan C.nr.141/13 i datës 09.01.2014 apo çështja të kthehet në rigjykim.

Ankesë gjithashtu ka parashtuar edhe i autorizuari i paditësit avokat N.G. për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan C.nr.141/13 i datës 09.01.2014 të ndryshohet.

Gjykata e Apelit pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, lidhur me Aktgjykimin e atakuar, konform dispozitave të nenit 194,195 dhe nenit 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditësit është pabazuar.

Ankesa e të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi G.B. nga fshati ... Komune e Lipjanit me datë 29.12.2011 ka ushtruar padi kundër të paditurës (BKS) në Prishtinë, të precizuar me anë të parashtresës datë 11.11.2013 me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura (BKS) në Prishtinë, që paditësit në emër të dëmit jo material dhe material si pasojë e aksidentit të datës 13.09.2013 t'ia kompensoj shumat dhe atë për dhimbje fizike shumë prej 1.500 euro, për frikën e përjetuar shumë prej 1.000 euro, për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit shumë prej 500 euro dhe dëmin material në emër të ushqimit të forcuar shumë prej 60 euro dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë shumë prej 30 euro, me kamatë ligjore të cilën e paguajnë bankat për mjetet e afatizuara mbi një vit, duke filluar nga data e ndodhjes së aksidentit e deri deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto nga dita e pranimit të Aktgjykimin në afat prej 15 ditësh, nën kërcnim të përmbarimit.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës kryesore dhe administrimit të provave vendosi si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar duke e aprovuar pjesërisht të bazuar kërkespadinë e paditësit, mbeshtetur në nenin 154, 155, 173, 174, 178, 195, dh nenit 200 të LMD-së, ndërsa sa i përket kamatës ligjore gjykata e shkallës së parë vendosi në bazë të nenit 277 të LMD-es, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata është bazuar në nenin 452.1 të LPK-së.

Në aryetimin e Aktgjykimin të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me datë 13.04.2009 rreth orës 20:00 në rrugën magjistrale Prishtinë- Prizren të udhëkryqi i Lipjanit, ka ndodhur aksident trafiku në atë mënyrë që deri sa drejtuesi i makinës Golf me targe XXX NN ishte duke qarkulluar në rrugë duke mos përshtatur shpejtësinë dhe vozitjen kushteve të rrugës dhe rregullave të komunikacionit me ç'rast me anën e majtë të automjetit të tij godet makinën e tipit Daimler Benz me targë xxx i cili ishte duke lëvizur në rrugë me përparësi kalimi, me ç'rast në cilësi të bashkëudhetarit lëndime trupore pëson paditësi G.B..

Lidhur me bazën juridike të kërkespadiës gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se e njëjta gjatë shqyrtimit kryesor nuk ishte kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse.

Ndërsa për natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësi dhe vërtetimin e lartësisë së kërkespadiës gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë ekspertizat mjekësore të përpiluara nga ekspertë mjekësor nga lëmia e ortopedisë-traumatologjisë dr.A.T. dhe nga lëmia e psikiatrisë dr.S.B., mendime këto të dhëna në seancën e mbajtur gjyqësore me datë 08.11 2013, pas ekzaminimit direkt të palës së dëmtuar dhe vlerësimit të dokumentacionit mjekësor.

Nga mendimi i përbashkët i eksperteve mjekësor është konstatuar se paditësi G.B. i lindur në vitin 1990, në aksidentin e datës 13.04.2009 ka pësuar ndrydhje të kokës plagë prerëse shqyese në regjionin frontoparietal të majtë, ndrydhje dhe gërvishje në të dy gjunjët, të cilat kualifikohen si lëndime të lehta trupore, e si pasojë e të cilave paditësi ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje 24 orëve kohë pas kohë deri në veprimin e terapisë adekuate, dhimbje fizike të shkallës së mesme në kohëzgjatje prej 10 diteve dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët edhe për një muaj, ka pasur nevojë për ndihmë nga personi i tretë për tri ditë, ushqim i përforcuar për 10 ditë, shëmtim të shkallës së lehte për shkak të cikatriksit i cili gjendet në regjionin e majtë të ballit në gjatësi prej 3 cm dhe e cila pjesë vazhdimisht është e ekspozuar ndërsa ka dhe një cikatriks në pjesë të kokës e cila aktualisht nuk duket për shkak të flokëve por me moshë si pasojë e rënies së flokëve mund edhe të duket në të ardhmën, ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur për disa sekonda që ka përjetuar si pasojë e ndrojes së çfarë do të ndodhë me shëndetin e tij, frikë sekondare e intensitetit të lartë në periudhë kohore gjer në dy orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm dhe të ulët ka qenë prezente edhe për gjashtë javë të ardhshme e përcjellur me simptoma të reagimit akut ndaj stresit , çrregullim gjumi, jo dipsonim dhe ankesa tjera trupore.

Duke u nisur nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkespadija e paditësit për dëmin jo material dhe material është pjesërisht e bazuar ku dhe ka vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar. Mënyrën e vendosjes lidhur me dëmin jo material të gjykuar paditësit, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar duke ju falë besimin mendimit profesionalë të dhënë nga ekspertë mjekësor si dhe provave tjera nga shkresat e lëndës, mbështetur në dispozitat e nenit 178.1, 179, 200.1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në dispozitën e nenit 452.2 të LPK-së.

Lidhur me pjesën e refuzuar të kërkesëpadinë rreth dëmit jomaterial në emër të përtej shumës së gjykuar, dhe dëmin material në emër të ndihmës së huaj dhe ushqimit të përforcuar gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se këtë pjesë të kërkesëpadiës paditësi nuk ka argumentuar me prova përkundër që ka qenë i obliguar që të argumentoj me prova të gjitha faktet e pretenduara, konform nenit 7 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së ka konstatuar se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje nga neni 182.2 pika b), g), j) k) dhe m) për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe nuk përmban as shkelje tjera procedurale sipas pretendimeve ankimore të paditësit dhe të paditurës të parashtruara përmes ankesave.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes përveç atyre jo kontestuese janë provuar me prova përkatëse të administruara në procedurën e provave si: mendimin dhe konstatimin e ekspertit të komunikacionit, eksperiza mjekësore të punuar nga ekspertët përkatës të mjeksisë.

Gjykata e Apelit gjithashtu sipas pretendimeve ankimore dhe ex officio ka vlerësuar zbatimin e të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar se në kuptim të dispozitave materiale juridike të cilave i është referuar gjykata e shkallës së parë në perputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësi si pasojë e aksidentit, natyrën e lëndimit, vuajtjen shpirtërore për shkak të shëmtimit, faktin se paditësi është i moshës së re dhe duke marrë për bazë të gjitha rrethanat tjera të cilat meren si kriter për përcaktimin e lartësisë së

kompenzimit siç janë (mosha, mënyra e manifestimit të dëmit, praktika gjyqësore) shumat e gjykuara janë në hamroni me qëllimin e kompenzimit.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar ka vendosur në harmoni në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatsisht dëmeve të pësuar nga paditesi, duke siguruar që kompenzimi i gjykuar të jetë satisfacion për paditësin, duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfacionit në raste të tilla.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se vendosja si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar sa i përket pjesës refuzuese, është vërtetuar dhe ka mbetur e pa shqyrtuar pasi pala paditëse nuk ka ushtruar ankesë, ndërsa pala e paditur nuk ka interes që aktgjykimi të goditet në këtë pjesë.

Mbi bazën e të lartëcekurave u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, konform dispozitave të nenit 194, 195 parag.1 pika d) dhe lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1012/14 më datë **27.10.2017**

KRYETARE E KOLEGJIT
Frosina Sylejmani